



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.13, datë 29.05.2023

P Ë R

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KKT-SË NR.03, DATË 10.11.2017
“PËR MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
“GODINË POLIFUNKSIONALE EUROPIANE BLOKU”, BASHKIA TIRANË


Në mbështetje të neneve 28, 29 dhe 113, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 14/1, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Invest Society” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

V E N D O S I:

1. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë, pjesë përbërëse e Vendimit të KKT-së Nr.03, datë 10.11.2017 “Për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin: “Godinë Polifunksionale Europiane Blloku”, Bashkia Tiranë, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë bashkangjitur këtij vendimi.
2. Procedurat administrative/ligjore të përmendura në Vendimin e KKT-së Nr.03, datë 10.11.2017, “Për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin: “Godinë Polifunksionale Europiane Blloku”, Bashkia Tiranë, do të vijohen nga Bashkia Tiranë, sipas përcaktimeve dhe rregullave të parashikuara në dispozitat e Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në përputhje me “Marrëveshjen për Delegimin e Kompetencave” të nënshkruar mes Kryetarit të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Kryetarit të Bashkisë Tiranë, në datë 10.11.2017, si dhe ndryshimin e saj, bashkëlidhur këtij Vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Bashkia Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

